Nr.11118-02623-00-2012 i Regj. Themeltar
Nr.00-2013-2562 i Vendimit (5)

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Ardian Dvorani	Kryesues
Arjana Fullani	Anëtare
Majlinda Andrea	Anëtare
Andi Çeliku	Anëtar
Medi Bici	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 08.01.2013, mori në shqyrtim çështjen civile që i përket:

PADITËS	SHOQËRIA "C.A.E" SHPK, TIRANË
I PADITUR	SHOQËRIA " ENERGJI" SHPK, TIRANË

OBJEKTI:
Përmbushje e detyrimit.
Shpërblim i dëmit të krijuar nga mospërmbushja e detyrimit.
Baza ligjore: Nenet 79 e vijues, 419 e vijues, 450, 476
dhe 640, 659 e 850 të K.Civil.
Nenet 31 e vijues dhe 153 e vijues të K.Pr.Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.7302, datë 11.07.2012, ka vendosur :

> Nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes civile nr.13115 Akti me palë paditëse Shoqëria "C.A.E" shpk dhe palë të paditur Shoqëria "ENERGJI" Shpk dhe me objekt përmbushje detyrimi dhe shpërblim dëmi.
> Heqjen e masës së sigurimit të padisë të vendosur me vendimin nr.319 Akti, datë 08.06.2012.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit, në mbështetje të Nenit 59 të K.Pr.Civile, ka ushtruar ankim të veçantë Shoqëria "C.A.E" SHPK, e cila kërkon prishjen e vendimit duke parashtruar këto shkaqe:

- Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e çështjes civile jashtë juridiksionit gjyqësor është një vendim i njëanshëm dhe i pabazuar në ligj.
- Palët kanë lidhur një marrëveshje, në datën 18.12.2007, në bazë të së cilës kanë rënë dakord të kryejnë punime gërmimi, hartuar në gjuhën italiane, nga dy shoqëri shqiptare të krijuara sipas legjislacionit shqiptar, me administratorë shqiptarë, me njohuri mesatare të gjuhës italiane.
- Kjo kontratë nuk mund të paraqitet si provë, siç pretendon pala e paditur, sepse pranë gjykatës provat duhet të paraqiten të noterizuara nga një noter publik, të vërtetuara prej tij dhe kjo marrëveshje nuk është e noterizuar, pra nuk plotëson kushtet e nenit 44 të ligjit nr.7829, datë 01.08.1994 për " Noterinë".
- Duke qenë se palët nuk janë paraqitur pranë një noteri shqiptar për të hartuar këtë kontratë, gjykata nuk duhet ta merrte si provë këtë marrëveshje.

- Shoqëria "C.A.E" shpk, ka prova dhe dëshmitarë okularë se kjo marrëveshje është hartuar dhe nënshkruar nën presion dhe mashtrim nga përfaqësuesi italian, mbikëqyrës i Shoqërisë "Energji" shpk, referuar nenit 233 të K.Pr.Civile e si pasojë gjykata duhej të verifikonte nëse kjo marrëveshje duhej provuar për vërtetësinë e saj përpara se ta njihte si provë.
- Përsa i takon "heqjes së masës së sigurimit të padisë të vendosur me nr.319 akti, datë 08.06.2012" shprehemi se: si ka mundësi që e njëjta gjyqtare, më datë 08.06.2012, me vendimin e saj nr.319 vendos masën e sigurisë, sekuestron në llogaritë bankare të Shoqërisë "Energji" shpk në banka të nivelit të dytë që operojnë në Shqipëri deri në vlerën e pretenduar të detyrimit 2.000.000 Euro, ndërkohë që një muaj më vonë, me vendimin e saj datë 11.07.2012, ajo e hedh poshtë këtë vendim. Pra ajo e njohu juridiksionin e gjykatës së shkallës së parë për vendimin e parë dhe nuk e njohu në të dytin.
- Kërkojmë prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes civile në gjykatën e rrethit, me tjetër trup gjykues.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Andi Çeliku; përfaqësuesin e palës paditëse av.Bledar Fejzo, i cili kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes kësaj gjykate për vazhdimin e gjykimit me të njëjtin trup gjykues; përfaqësuesin e palës së paditur av.Florian Hasko, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor; dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Shoqëria "C.A.E" Shpk është person juridik shqiptar, me objekt të veprimtarisë së saj, ndërtimin e objekteve civile dhe industriale, zyrave, rrugëve, hekurudhave, porteve, etj.

Shoqëria "Energji" Shpk është gjithashtu person juridik shqiptar, me objekt të veprimtarisë së saj financim, ndërtim impiantesh elektrike dhe aktivitete në fushën e energjisë.

Të dyja këto shoqëri kanë hyrë në një marrëdhënie kontraktuale, objekti i së cilës ka qenë kryerja e punimeve të gërmimit nga Shoqëria "C.A.E" Shpk në kantierin e Hidrocentralit të Kalivaçit, për llogari dhe interes të Shoqërisë "Energji" Shpk. Kjo marrëdhënie midis palëve është formalizuar me nënshkrimin e kontratës datë 18.12.2007.

Me pretendimin se nuk është paguar për punimet e kryera, Shoqëria "C.A.E" Shpk, më datë 05.06.2012 ka paditur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë Shoqërinë "Energji" Shpk, duke kërkuar përmbushjen e detyrimit kontraktor dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mospërmbushja e detyrimit. Po kështu, Shoqëria "C.A.E" Shpk ka kërkuar edhe marrjen e masës së sigurimit të padisë, në mbështetje të nenit 202 e vijues të K.Pr.Civile. Me vendimin nr.319 Akti, datë 08.06.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka pranuar kërkesën e paditësit për marrjen e masës së sigurimit të padisë, nëpërmjet vendosjes së sekuestros mbi llogaritë bankare të Shoqërisë "Energji" Shpk.

Duke ju referuar nenit 24.2 të marrëveshjes datë 18.12.2007 të lidhur midis palëve ndërgjyqëse, i padituri, Shoqëria "Energji" Shpk, ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, me pretendimin se autoriteti kompetent që duhet të zgjidhë mosmarrëveshjet midis këtyre palëve është Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë Paris (Arbitrazhi).

Pala paditëse ka prapësuar këtë kërkim të palës së paditur me pretendimin se marrëveshja e lidhur midis palëve ndërgjyqëse nuk përbën burim të drejtash dhe detyrimesh juridiko civile, pasi është e lidhur në gjuhë të huaj, e pa përkthyer dhe e pa noterizuar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.7302, datë 11.07.2012, ka vendosur:

"Nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes civile nr.13115 Akti me palë paditëse Shoqëria "C.A.E" shpk dhe palë të paditur Shoqëria "ENERGJI" Shpk dhe me objekt përmbushje detyrimi dhe shpërblim dëmi. Heqjen e masës së sigurimit të padisë të vendosur me vendimin nr.319 Akti, datë 08.06.2012".

Në vendimin e saj Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë arsyeton se*: Juridiksioni gjyqësor përfaqëson atributet e gjykatës së zakonshme të përcaktuara me ligj për të shqyrtuar një çështje gjyqësore konkrete. Një aftësi e tillë parimisht i është dhënë gjykatës nga ligji si një tagër i përgjithshëm përjashtimet nga i cili si rregull ekzistojnë për dy shkaqe:*

1) Për shkak të një kufizimi ligjor; 2) për shkak të një marrëveshjeje ***të vullnetshme*** *dhe* ***të vlefshme*** *mes palëve për shmangien nga parimi i përgjithshëm i juridiksionit dhe adresimin e mosmarrëveshjes për zgjidhje në një juridiksion tjetër.*

Konstatohet se palët ndërgjyqëse, përkatësisht Shoqëria "C.A.E" Shpk dhe Shoqëria "Energji" Shpk, me marrëveshje të plotë dhe në përputhje me parimin universal të lirisë kontraktuale kanë nënshkruar kontratën e datës 18 Dhjetor 2007, duke përcaktuar në nenin 24.2 të saj autoritetin që do të zgjidhë mosmarrëveshjet eventuale përpara, gjatë dhe pas ekzekutimit të kontratës. Në këtë marrëveshje palët kanë përcaktuar në mënyrë të detajuar se mosmarrëveshja do të gjykohet përfundimisht sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Parisit dhe se mosmarrëveshja do të zgjidhet nga tre arbitra të zgjedhur sipas këtyre rregullave.

Pretendimi i palës paditëse se kontrata e datës 18 Dhjetor 2007 është lidhur në gjuhë të huaj dhe nuk përbën burim të drejtash dhe detyrimesh juridiko-civile, për rrjedhojë nuk mund të shërbejë si bazë referimi për përcaktimin e juridiksionit gjyqësor, është i pabazuar në ligj.

Në ligjin nr.8687 datë 09.11.2000, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën Evropiane të Arbitrazhit, neni 6, pika 2 parashikohet shprehimisht:

"Gjykata e shteteve kontraktuese, në marrjen e vendimit lidhur me ekzistencën ose vlefshmërinë e një marrëveshjeje arbitrazhi, do të shqyrtojë vlefshmërinë e një marrëveshjeje të tillë duke iu referuar zotësisë juridike të palëve, sipas ligjit të tyre të zbatueshëm, si dhe lidhur me çështje të tjera si vijon: - <u>Sipas ligjit, të cilit palët kanë nënshkruar marrëveshjen e tyre të arbitrazhit</u>*".*

Në referim të kësaj dispozite të detyrueshme për zbatim nga gjykata dhe më me përparësi me ligjin e zakonshëm procedural civil gjykata konstaton se në nenin 4.3 të Kontratës së datës 18 Dhjetor 2007 palët kanë përcaktuar shprehimisht se: ***"Kjo kontratë është lidhur në bazë të së drejtës shqiptare****".*

Siç edhe u theksua më lart, të dy shoqëritë palë në këtë marrëveshje janë regjistruar dhe themeluar në përputhje me Legjislacionin Shqiptar të Shoqërive Tregtare dhe janë regjistruar në Regjistrin Shqiptar të Shoqërive Tregtare; për rrjedhojë në përcaktimin e vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit, gjykata vlerëson se palët në këtë çështje kanë të njëjtën zotësi juridike e cila rregullohet në bazë të legjislacionit shqiptar.

*Në legjislacionin shqiptar dhe në jurisprudencë kontrata përkufizohet si "****veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë, ose shuajnë një marrëdhënie juridiko-civile" (neni 659 i K.Civil Shqiptar).***

Në nenin 663 të K.Civil janë renditur kushtet e nevojshme për ekzistencën e kontratës duke parashikuar se: ***"Konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë: pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji".***

Kontrata e datës 18 Dhjetor 2007 përfaqëson një kontratë të shkruar me të drejta dhe detyrime të dyanshme, lidhur dhe nënshkruar me vullnet të plotë e të lirë prej palëve të saj

dhe në një gjuhë të pranuar nga palët. Vetë akti i nënshkrimit të kontratës dhe ekzekutimi i mëvonshëm i saj nga të dy palët reflekton pranimin e kësaj forme të kontratës. Kjo kontratë ka të përcaktuar qartë palët, përmban të drejta dhe detyrime të dyanshme, objekti i saj është i përcaktuar dhe i ligjshëm. Për shkak të llojit dhe sferës së veprimtarisë që ajo trajton kemi të bëjmë me një kontratë objekti i të cilës kërkon ekzekutimin e saj me veprime të shprehura, kryerjen e punimeve nga njëra palë kundrejt detyrimit për pagimin e vlerës së tyre nga pala tjetër. Ekzistenca e njëkohshme e këtyre elementëve përbëjnë kushtet ligjore për qenien e një kontrate të vlefshme juridikisht në kuptim të nenit 663 të K.Civil.

Në këto kushte, pretendimi i palës paditëse se kontrata e datës 18 Dhjetor 2007 nuk përbën burim të drejtash dhe detyrimesh juridiko civile e si e tillë gjykata nuk mund t`i referohet për përcaktimin e juridiksionit, ***nuk gjen asnjë mbështetje ligjore****.*

Nga ana tjetër, gjykata konstaton se klauzola e arbitrazhit e përcaktuar në nenin 24, pika 2 të marrëveshjes referon në një institucion arbitrazhi (Dhoma e Tregtisë së Parisit), përkatësisht dhe në përputhje me Konventën ka përcaktuar se arbitrat zgjidhen sipas rregullores së Institucionit përkatës dhe jo emërimin " Ad-Hoc" të arbitrave.

Në këto kushte, në referencë të nenit 24.2 të kontratës së datës 18 Dhjetor 2007 si dhe referuar në nenet 403 dhe 404 të K.Pr.Civile, klauzola e arbitrazhit për gjykimin e mosmarrëveshjes mes palëve ndërgjyqëse është e vlefshme dhe për rrjedhojë, mosmarrëveshja e paraqitur për shqyrtim nuk është në juridiksionin gjyqësor dhe në referencë të nenit 59 të K.Pr.Civile, gjykata konkludon në nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

Për rrjedhojë, në kushtet kur pala paditëse, Shoqëria "CAE" shpk, nuk ka paraqitur padi në juridiksionin kompetent, në këtë rast Dhoma e Tregtisë së Parisit, por në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila sipas analizës së mësipërme nuk ka juridiksion për shqyrtimin dhe gjykimin e saj, gjykata vlerëson se në kushtet kur çmohet nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor edhe masa e sigurimit të padisë duhet të hiqet".

Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në mbështetje të Nenit 59 të K.Pr.Civile, ka paraqitur ankim të veçantë Shoqëria "C.A.E" Shpk, duke kërkuar prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkaqet e përshkruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Në seancën gjyqësore të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, pala ankuese, ndryshe nga çfarë kishte parashtruar në ankimin e veçantë, pretendoi vetëm faktin se marrëveshja për arbitrazh ndërkombëtar sipas nenit 24.2 të kontratës 18.12.2007 vjen ndesh me ligjin, konkretisht me nenin 400 e vijues të K.Pr.Civile.

Në seancë gjyqësore nga paditësi, Shoqëria "C.A.E" Shpk, u ngritën pretendime edhe në lidhje me heqjen e masës së sigurimit të padisë nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në vendimin e saj për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Në kushtet kur kundër vendimit të heqjes së masës së sigurimit të padisë lejohet ankim i veçantë në gjykatën e apelit, sipas rregullave të përcaktuara në nenet 209, 210 të K.Pr.Civile dhe ky ankim (kjo e drejtë) nuk është ushtruar nga paditësi, pretendimet në lidhje me heqjen e masës për sigurimin e padisë dhe pjesa e vendimit që bën fjalë për këtë fakt nuk përbëjnë objekt shqyrtimi në Gjykatën e Lartë e rrjedhimisht kjo gjykatë nuk do të shprehet për këtë pjesë të vendimit.

Në këto kushte, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mori në shqyrtim vetëm ankimin e veçantë kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Pas shqyrtimit në tërësi të pretendimeve të palëve dhe akteve të administruara, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi nr.7302, datë 11.07.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor është një vendim i argumentuar dhe bazuar ligjërisht dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Në nenin 24.2 të marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse datë 18 Dhjetor 2007 është parashikuar se: **Mosmarrëveshja do të gjykohet përfundimisht sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Parisit; - Mosmarrëveshja do të gjykohet nga tre arbitra të caktuar në përputhje me këto rregulla; - Arbitrazhi duhet të zhvillohet në gjuhën e përdorur për komunikimet, siç parashikohet në pikën 4.3** (e drejta dhe gjuha).

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon se është e drejta e palëve në një kontratë që i nënshtrohet ligjit shqiptar, e lidhur nga subjekte shqiptare, për t'ia nënshtruar mosmarrëveshjet në lidhje me kontratën një gjykatë arbitrazhi, qoftë ky edhe arbitrazh ndërkombëtar. Ndërkohë, neni 400 e vijues i K.Pr.Civile, mbi të cilin mbështet pretendimet paditësi, bën fjalë për raste kur vendi i procedurës së arbitrazhit ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, pra jo për rastin objekt gjykimi. Për rastin objekt gjykimi do të duhej t'i referoheshim nenit 439 të K.Pr.Civile "Arbitrazhi Ndërkombëtar", sipas të cilit, pas ndryshimeve të vitit 2001 "Arbitrazhi ndërkombëtar rregullohet me ligj të veçantë". Në mungesë të ligjit të veçantë për rregullimin e arbitrazhit ndërkombëtar, çdo marrëveshje ndërkombëtare ose konventë e ratifikuar nga vendi ynë do të gjejë zbatim në rastin objekt gjykimi, si pjesë e së drejtës së brendshme.

Në nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar se "*Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të*". Ndërkohë neni 116 i Kushtetutës sonë përcakton aktet normative që kanë fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku renditen: **a) Kushtetuta**, **b) Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara**, **c) ligjet.....**

Po kështu, neni 122 i Kushtetutës sanksionon: *1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetë zbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji.....2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.....*

Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.8688, datë 09.11.2000, ka ratifikuar "Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit", hartuar nga O.K.B, në 10.06.1958, hyrë në fuqi me 07.06.1959.

Në të tilla rrethana, Konventa për Njohjen dhe Ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit, jo vetëm që zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë pasi është pjesë e rendit tonë juridik, por mbizotëron ndaj çdo parashikimi ligjor të së drejtës sonë të brendshme.

Në nenin 2 të kësaj Konvente është parashikuar se: "*1. Secila nga shtetet kontraktuese do të njohë marrëveshjen e shkruar, sipas së cilës palët marrin përsipër t'ia paraqesin arbitrazhit të gjitha ose ndonjë mosmarrëveshje, që kanë lindur ose mund të lindin ndërmjet tyre lidhur me një marrëdhënie juridike të caktuar, kontraktore ose jokontraktore, që ka lidhje me një çështje, e cila mund të rregullohet me anë arbitrazhi. 2. Termi "marrëveshje e shkruar" do të përfshijë një klauzolë arbitrazhi në një kontratë ose në një marrëveshje arbitrazhi e nënshkruar nga palët ose që përmbahet në një shkëmbim letrash ose telegramesh*".

Nga përmbajtja e nenit 24.2 të marrëveshjes së palëve rezulton se ato kanë rënë dakord që ndonjë mosmarrëveshje që mund të lindë nga zbatimi i kontratës së shkruar, ta zgjidhin përfundimisht sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë Paris, nga një trupë prej tre arbitrash të zgjedhur sipas rregullave të atij arbitrazhi. Kjo marrëveshje midis palëve për zgjidhjen e ndonjë konflikti të mundshëm nëpërmjet arbitrazhit ndërkombëtar është e vlefshme ligjërisht dhe e mirëpërcaktuar. Në të njëjtën kohë, pretendimet e paditësit për pavlefshmëri të kontratës nuk ndikojnë në çështjen e juridiksionit të arbitrazhit ndërkombëtar pasi marrëveshja e arbitrazhit është autonome nga kontrata që e përfshin ose me të cilën lidhet, duke bërë kështu që vlefshmëria e saj të vlerësohet në mënyrë

autonome pa u prekur nga pavlefshmëria e kontratës kryesore (nëse diçka e tillë konstatohet), përveç kur kjo bie ndesh me një parim të rendit publik. Ky parim është përfshirë edhe në Rregullat e Arbitrazhit Ndërkombëtar të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (I.C.C) në të cilat parashikohet se: *Gjykata e Arbitrazhit nuk do të pushojë së pasuri juridiksion për shkak të ndonjë pretendimi mbi mos ekzistencën ose nulitetin e kontratës. Gjykata e arbitrazhit do të vazhdojë të ketë juridiksion në përcaktimin e të drejtave përkatëse të palëve dhe të vendosë mbi kërkimet e tyre dhe pse kontrata kryesore në vetvete mund të jetë inekzistente ose nul* (neni 6, pika 9)

Mbështetur në sa sipër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konkludon se për mosmarrëveshjet e tashme dhe të ardhshme, përsa i përket zbatimit të kontratës së datës 18.12.2007 të lidhur midis palëve ndërgjyqëse, asnjë gjykatë në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk ka juridiksion për t'i shqyrtuar e zgjidhur ato. Mosmarrëveshjet objekt gjykimi janë, siç kanë parashikuar vetë palët, objekt i shqyrtimit dhe zgjidhjes nga arbitrazhi i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë Paris.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 59 të K.Pr.Civile,

V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit nr.7302, datë 11.07.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përsa i përket çështjes së juridiksionit.

Tiranë, me 08.01.2013

MENDIMI I PAKICËS

Si gjyqtar në pakicë kam qëndrimin se Kolegji Civil nuk duhet të kishte vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.7302, datë 11.07.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, por duhet të kishte vendosur prishjen e atij vendimi dhe dërgimin e çështjes po kësaj gjykate për vazhdimin e gjykimit, për shkak se shqyrtimi i kësaj çështjeje i përket juridiksionit gjyqësor shqiptar.

Duke afirmuar vetë arsyetimin e bërë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me ligjin e zbatueshëm dhe juridiksionin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykim, shumica e Kolegjit Civil, në thelb, ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejt ligjin shqiptar dhe të drejtën ndërkombëtare.

Shumica e Kolegjit Civil arsyeton se palët ndërgjyqëse, në marrëveshjen (kontratën) e lidhur mes tyre, në pikën 24.2 të saj, kanë parashikuar që nëse nuk i zgjidhin miqësisht mosmarrëveshjet mes tyre do të gjykohen përfundimisht sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Parisit. Është e drejta e palëve që lidhin kontratën sipas ligjit shqiptar që t;ia nënshtrojnë mosmarrëveshjet mes tyre një gjykate arbitrazhi, qoftë ky edhe arbitrazh ndërkombëtar.

Sipas nenit 5 dhe 116 të Kushtetutës, e drejta ndërkombëtare e njohur nga shteti shqiptar është pjesë e së drejtës së brendshme, ka epërsi dhe zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi në hierarkinë e normave juridike vjen menjëherë pas Kushtetutës.

Sipas Konventës së Nju Jorkut të viti 1958 për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit, nenit 2, pikat 1 e 2, shtetet kontraktuese janë të detyruara të njohin marrëveshjen e palëve në një kontratë për t'ia paraqitur zgjidhjen e mosmarrëveshjejeve mes tyre një gjykate arbitrazhi. Marrëveshja për arbitrazh duhet të jetë

“marrëveshje e shkruar” si klauzolë e kontratës, si marrëveshje e veçantë apo në forma të tjera të njohura nga Konventa.

Në të tilla kushte, për të vlerësuar nëse çështja bën ose jo pjesë në juridiksionin gjyqësor shqiptar referimi dhe mbështetja ligjore duhet të bëhet në dispozitat e sipërcituara të Konventës së Nju Jorkut të vitit 1958, në të cilën Shqipëria ka aderuar me ligjin nr.8688, datë 09.11.2000.

Në këtë mënyrë, shumica e Kolegjit Civil konkludon se mosmarrëveshja objekt gjykimi nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor shqiptar, ajo do të gjykohet, sikurse kanë parashikuar vetë palët në marrëveshje, nga arbitrazhi ndërkombëtar, Dhoma e Tregtisë në Paris.

Si gjyqtar në pakicë kam mendimin se arsyetimi dhe përfundimet e shumicës së Kolegjit Civil janë rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit procedural civil dhe vetë të drejtës ndërkombëtare të zbatueshme përsa i përket përcaktimit të rasteve dhe kushteve se kur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile e tregtare vepron juridiksioni gjyqësor vendas (shqiptar) dhe kur ai i huaj, kur dhe në cilat raste, pavarësisht nga marrëveshja e palëve, jemi përpara pengesës a ndalimit të shqyrtimit të çështjes nga juridiksioni i huaj.

Shumica e Kolegjit Civil, sikurse edhe gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e tyre, në mënyrë korrekte kanë interpretuar përmbajtjen e dispozitave kushtetuese, dispozitat procedurale civile, si edhe ato të normave të së drejtës ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me përcaktimin e juridiksionit vendas a të huaj për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykim.

Por, si gjyqtar në pakicë, duke qenë se objekt gjykimi është çështja e juridiksionit, kam qëndrimin se, edhe kryesisht, shumica e Kolegjit Civil duhet të mbante parasysh, të interpretonte e zbatonte edhe disa dispozita të tjera të së drejtës shqiptare dhe ndërkombëtare.

Kështu, në ligjin nr.10428, datë 02.06.2011 “*Për të drejtën ndërkombëtare private*”, në nenin 1 parashikohet se:

“Neni 1 Objekti i ligjit

1. Ky ligj përcakton:

a) rregullat për ligjin që zbatohet në marrëdhëniet juridike civile, të cilat kanë ***elemente të huaja;***

b) juridiksionin dhe rregullat procedurale të gjykatave shqiptare për marrëdhëniet juridike civile, të cilat kanë ***elemente të huaja.***

2. "Elementi i huaj", për qëllime të zbatimit të këtij ligji, nënkupton çdo rrethanë juridike që lidhet me subjektin, përmbajtjen ose objektin e një marrëdhënieje juridiko-civile dhe që bëhet shkak për lidhjen e kësaj marrëdhënieje me një sistem ligjor të caktuar.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite, si gjyqtar në pakicë, vlerësoj se në çështjen objekt gjykimi nuk jemi as përpara një marrëdhënie juridike-civile (veprimi juridik) dhe as përpara ndonjë mosmarrëveshjeje e cila ka elementë të huaj”.

Palët ndërgjyqëse (kontraktore), si pala paditëse edhe pala e paditur, janë persona juridikë të së drejtës shqiptare. Në këtë kuptim, nuk ka vend për zbatimin e parimeve dhe normave procedurale të këtij ligji, përsa i përket çështjeve të juridiksionit gjyqësor shqiptar apo të huaj për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile. Palët ndërgjyqëse janë persona juridikë të së drejtës shqiptare, mosmarrëveshja mes tyre është e lidhur me të drejta subjektive dhe interesa që kanë lindur, realizohen dhe ekzekutohen në territorin shqiptar.

Prandaj, në kushte të tilla nuk ka vend që të referohemi në nenin 2 të ligjit, sipas të cilit*: “Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë epërsi mbi dispozitat e këtij ligji, kur dispozitat e tij nuk pajtohen me to”*.

Gjithashtu, në nenin 71 të këtij ligji parashikohet se *:*

"Neni 71 "Rregulli i përgjithshëm i juridiksionit ndërkombëtar"

Gjykatat shqiptare kanë juridiksion në zgjidhjen e ***mosmarrëveshjeve juridiko-civile me elemente të huaja,*** *nëse pala e paditur ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, përveçse kur rregullat e këtij kreu parashikojnë ndryshe".*

Nga interpretimi i kësaj dispozite dhe atyre vijuese të këtij ligji lidhur me juridiksionin, si gjyqtar në pakicë, vlerësoj se juridiksioni i gjykatave shqiptare nuk mund të vihet në diskutim, përveçse në rrethanat kur mosmarrëveshja ka elementë të huaj. Por në çështjen objekt gjykimi, sikurse arsyetoj më sipër nuk ka elementë të huaj, ndaj edhe nuk mund të vihet në diskutim ekzistenca dhe zbatimi i detyrueshëm i juridiksionit gjyqësor shqiptar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi.

Akoma më tej, si gjyqtar në pakicë, vlerësoj se, si shumica e Kolegjit Civil, ashtu edhe gjykata e shkallës së parë nuk kanë mbajtur parasysh zbatimin e detyrueshëm të dispozitave të Konventës Europiane të Arbitrazhit (Konventa e Gjenevës e vitit 1961), në të cilën Shqipëria ka aderuar me ligjin nr.8687, datë 9.11.2000. Në këtë Konventë, mes të tjerave parashikohet se:

"*Neni 1 "Fusha e zbatimit të Konventës"*

Kjo Konventë zbatohet :

a. për marrëveshjet e përfunduara të arbitrazhit që kanë për qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin nga tregtia ndërkombëtare ndërmjet personave fizikë ose juridikë, të cilët në çastin e përfundimit të marrëveshje e ***kanë selinë e tyre të zakonshme ose qendrën e tyre në shtetet kontraktuese të ndryshme;"*****.....**

Neni 6 "Juridiksioni i gjykatës"

.....2. Gjykata e shteteve kontraktuese, në marrjen e vendimit lidhur me ekzistencën ose vlefshmërinë e një marrëveshjeje arbitrazhi, do të shqyrtojë vlefshmërinë e një marrëveshjeje të tillë duke iu referuar zotësisë juridike të palëve, sipas ligjit të tyre të zbatueshëm, si dhe lidhur me çështje të tjera si vijon:

… sipas ligjit, të cilit palë i kanë nënshkruar marrëveshjen e tyre të arbitrazhit;.....

.....Gjykata, mundet, gjithashtu, të refuzojë njohjen e marrëveshjes së arbitrazhit në rast se sipas ligjit të vendit të tyre, mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet nga arbitrazhi".

Si gjyqtar në pakicë, nga përmbajtja e këtyre normave të së drejtës ndërkombëtare, vlerësoj se klauzola e arbitrazhit ndërkombëtar e rënë dakord mes palëve ndërgjyqëse në pikën 24.2 të marrëveshjes (kontratës) së lidhur mes tyre, është një klauzolë e pavlefshme dhe se mosmarrëveshja mes palëve ndërgjyqëse nuk mund të zgjidhet nga arbitrazhi ndërkombëtar. Shkronja "a" e nenit 1 të Konventës të sipërcituar, qartësisht parashikon se arbitrazhi ndërkombetar mund të veprojë vetëm nëse palët "*e* ***kanë selinë e tyre të zakonshme ose qendrën e tyre në shtetet kontraktuese të ndryshme*****".** Sikurse ka pranuar gjykata e shkallës së parë dhe vetë shumica e Kolegjit Civil, të dy palët ndërgjyqëse janë persona juridikë shqiptarë dhe natyralisht selinë e tyre e kanë në Republikën e Shqipërisë.

Po kështu, nisur nga përmbajtja e nenit 6 të kësaj Konvente, si gjyqtar në pakicë arrij në të njëjtin përfundim. Kjo për shkak se Konventa i ka njohur gjykatës të drejtën të refuzojë njohjen e marrëveshjes së arbitrazhit sipas ligjit shqiptar. Sipas ligjit nr.10428, datë 02.06.2011 të sipërcituar, mosmarrëveshja objekt gjykimi nuk mund të zgjidhet nga juridiksioni i gjykatave të huaja apo arbitrazhi ndërkombëtar.

Së fundi, shumica e Kolegjit Civil, sikurse edhe gjykata e shkallës së parë, për të konkluduar se gjykata shqiptare nuk ka juridiksion për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykim, i janë referuar dispozitave të Konventës së Nju Jorkut të viti 1958 për "Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", por vetëm nenit 2, pikave 1 e 2 të tij.

Si gjyqtar në pakicë, kam mendimin se interpretimi dhe zbatimi i normave të kësaj Konvente prej tyre është i mangët, për shkak se duhet të mbaheshin parasysh jo vetëm qëllimi dhe fusha e veprimit të saj, por edhe përmbajtja e dispozitave të tjera të Konventës që posaçërisht lidhen me fushën e zbatimit të Konventës dhe kushtet përkatëse.

Kështu, në nenin 2 përmbahet edhe pika 3 e tij, ku parashikohet se*:*

"3. Gjykata e njërit shtet kontraktues, kur është e angazhuar në një padi për një çështje për të cilën palët kanë bërë një marrëveshje sipas kuptimit të këtij neni, me kërkesën e një prej palëve ia referon palët arbitrazhit, ***<u>përveç rasteve kur ajo gjen se marrëveshja në fjalë është nul dhe e pavlefshme, jo operative ose e pamundur për t'u zbatuar.</u>***

Së pari, si gjyqtar në pakicë, kam mendimin se thelbësore ishte të mbahej parasysh që qëllimi i kësaj Konvente nuk është të përcaktojë rastet se kur klauzola apo marrëveshja për arbitrazh ndërkombëtar është e vlefshme por të vendosë disa parime dhe rregulla të detyrueshme për shtetet kontraktuese, në rastet kur një mosmarrëveshje është zgjidhur tashmë nga gjykata ndërkombëtare e arbitrazhit dhe nevojitet që ajo të ekzekutohet në një shtet të ndryshëm nga ai ku është dhënë vendimi i gjykatës së arbitrazhit (neni 1 pika 1 e Konventës).

Së dyti, vetë Konventa, në dispozitën e pikës 3 të nenit 2 të sipërcituar, ka lejuar gjykatën e shtetit kontraktues ku kërkohet të ekzekutohet vendimi i gjykatës ndërkombëtare të arbitrazhit, që të vlerësojë nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhej apo jo nga ajo gjykatë ndërkombëtare e arbitrazhit, nisur nga vlerësimi nëse marrëveshja për arbitrazh ishte apo jo e vlefshme sipas legjislacionit të saj.

Prandaj edhe në nenin 5 të kësaj Konvente parashikohet qartësisht se:

"Neni 5

.....2. Njohja dhe ekzekutimi i një vendimi të arbitrazhit mund të refuzohen gjithashtu në qoftë se autoriteti kompetent i vendit ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi konstaton se:
<u>objekti i mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet në rrugë arbitrazhi, sipas ligjit të atij vendi</u>*, ose....."*

Më sipër, në parashtrimin e qëndrimit tim, kam arsyetuar që mosmarrëveshja mes palëve ndërgjyqëse në çështjen objekt gjykimi nuk mund të zgjidhej në rrugën e arbitrazhit ndërkombëtar. Kështu që, dispozita e mësipërme e nenit 5 të Konventës, konfirmon më tej qëndrimin se gjykata e juridiksionit, jo vetëm në momentin e fillimit të konfliktit por edhe kur i paraqitet për shqyrtim çështja e ekzekutimit të një vendimi arbitrazhi ndërkombëtar, jo vetëm ka të drejtën por edhe detyrimin për të vlerësuar nëse ka apo jo pengesë që mosmarrëveshja të ishte në juridiksionin gjyqësor të huaj apo të arbitrazhit ndërkombëtar.

Prandaj, duke patur parasysh sa arsyetohet më sipër, si gjyqtar në pakicë kam qëndrimin se shumica e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk duhet të kishte vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.7302, datë 11.0171.2012 të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, por duhet të dispononte për prishjen e atij vendimi dhe detyrimin e gjykatës të vazhdonte gjykimin, pasi shqyrtimi i mosmarrëveshjes bën pjesë në juridiksionin gjyqësor ekskluziv shqiptar.

Ardian Dvorani